

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 8078  
E shtunë, 21 qershor 2025  
Çmimi 0.50 €

Sondazhi i UBO  
Consulting: LV-ja fajësohet  
32.6 % për bllokadën  
në Kuvend, pasuar  
nga PDK-ja

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## QEVERIA E KOSOVËS SYNON T'I NDËRTOJË DY URA TË REJA PRANË URËS KRYESORE MBI IBËR NË MITROVICË

FAQE 4-5



Synimi për ndërtimin e këtyre dy urave vjen disa ditë pasi Mitrovica - qyteti i ndarjes më të theksuar etnike në Kosovë - themeloi Bordin e Përbashkët në mes

të komunës jugore me shumicë shqiptare dhe asaj veriore me shumicë serbe. Lëvizja Vetëvendosje, e udhëhequr nga kryeministri në detyrë Albin Kurti, ka

publikuar një fotografi e cila tregon se si do të dukeshin këto dy ura. Ato do të ndërtoheshin në anën e majtë dhe të djathtë të urës kryesore

### OPINION

TRE LUGETËR PARA VARRIT TË  
ADEM DEMAÇIT F. 6

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



### AKTUALE



SAMITI NË HAGË PRITET  
TA KONFIRMOJË SHOQPËRINË  
MIKPËRITËSE TË SAMITIT  
TË NATO-S MË 2027 F. 5

KURTI TAKON AMBASADORIN  
ÇOBAJ DHE MALAJ, TEMË DISKUTIMI  
FORCIMI I RAPORTEVE F. 6

OWADA: AJO QË ËSHTË ARRITUR NË  
KOSOVË ËSHTË TRIUMF NJERËZOR F. 6

### EKONOMI

KESCO APELON PËR KURSIM  
TË ENERJISË ELEKTRIKE  
PËR SHKAK TË MUNGESËS  
SË PRODHIMIT VENDOR F. 8

HOTI: KRIZA ENERJETIKE  
PO E RRËNON EKONOMINË F. 8

### SPORT



MBI NJË MIJË FËMIJË VRAPUAN NË  
PRISHTINË PËR DITËN OLIMPIKE

F. 10

**KMDLNJ:  
FADIL FAZLIUT  
PO I MOHOMET  
MBROJTJA  
NË HAGË F. 7**



**HARADINAJ  
PARALAJMËRON KURTIN:  
BOLL ËSHTË BOLL!  
DO TË KENI PASOJA  
NËSE NUK NDALENI SË  
BLLOKUARI VENDIN F. 5**



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Konflikti Izrael - Iran hyn në javën e dytë, Evropa synon një zgjidhje diplomatike

**JERUSALEM, 20 QERSHOR** - Konflikti ajror në mes të Izraelit dhe Iranit ka hyrë në javën e dytë më 20 qershor teksa zyrtarët evropianë po tentojnë ta kthejnë Teheranin në tavolinën e negociatave, pasi presidenti amerikan, Donald Trump, tha se një vendim potencial për përfshirjen amerikane do të merret brenda dy javësh.

Izraeli nisi fushatën ushtarake ndaj Iranit më 13 qershor, duke thënë se synon ta parandalojë armikun e përbetuar nga krijimi i armëve bërthamore. Irani u kundërpërgjigj me sulme me raketa dhe dronë ndaj Izraelit. Teherani thotë se programi i tij bërthamor është për qëllime civile.

Sulmet izraelite kanë vrarë të paktën 224 persona në Iran, ndërkaq Izraeli ka raportuar për 24 viktima nga sulmet iraniane.

Izraeli ka shënjestruar aftësitë bërthamore dhe raketore të Iranit, me synimin për ta shkatërruar qeverinë dhe udhëheqësin suprem iranian, ajatollah Ali Khamenei, sipas zyrtarëve perëndimorë dhe rajonalë. "A po godasim për ta rrëzuar regjimin? Ndoshta ky do të jetë rezultati, por është në dorën e popullit iranian që të ngrihet për lirinë e vet", tha

kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu të enjten.

Irani ka thënë se ka shënjestruar objekte ushtarake dhe të lidhura me mbrojtjen në Izrael, megjithëse ka goditur një spital dhe disa caqe të tjera civile.

Me asnjërin palë që nuk po tërhiqet, ministri i Jashtëm i Britanisë, i Francës dhe i Gjermanisë, së bashku me shefen për politikë të jashtme të Bashkimit Evropian, pritët të takohen të premten në Gjenevë me ministrin e Jashtëm iranian, në përpjekje për t'i ulur tensionet. "Tani është koha t'u japim fund skenave të rënda në Lindjen e Mesme dhe të parandalojmë një përshkallëzim rajonal që nuk do t'i sillte dobi askujt", tha sekretari i Jashtëm britanik, David Lammy, para takimit të përbashkët me ministrin e Jashtëm iranian, Abbas Araqchi.

Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, gjithashtu u takua me Lammyn të enjten dhe zhvilloi biseda të ndara telefonike me homologët e tij nga Australia, Franca dhe Italia për të diskutuar rreth konfliktit. Departamenti amerikan i Shtetit tha se Rubio dhe ministrat e Jashtëm u pajtuan që "Irani nuk mund të zhvillojë



asnjëherë apo të posedojë armë bërthamore".

Lammy tha të njëjtën gjë përmes një postimi në X, duke shtuar se situata në Lindjen e Mesme "mbetet e rrezikshme" dhe se tani "ekziston mundësia që brenda dy javësh të arrihet një zgjidhje diplomatike".

Shtëpia e Bardhë tha se Trumpi

do të marrë pjesë në takimin e sigurisë kombëtare mëngjesin e së premtes. Presidenti amerikan e ka kërcënuar Teheranin, gjithashtu ka bërë thirrje për rinisjen e bisedimeve bërthamore në mes të Uashingtonit dhe Teheranit, që u pezulluan për shkak të konfliktit.

Në agimin e së premtes, ushtria izraelite lëshoi një paralajmërim të ri për një breshëri raketash të lëshuara nga Irani. Të paktën njëra prej tyre goditi drejtpërdrejt në Ber Sheva, qytetin më të madh në jug të Izraelit, që ka qenë shënjestër e sulmeve ditët e fundit.

Raketa goditi pranë ndërtesave të banimit, zyrave dhe objekteve industriale, duke shkaktuar dëme materiale. "Kishte një goditje të drejtpërdrejtë pranë njëres prej banesave. Dëmet këtu janë mjaft të mëdha", tha mjeku Shafir Botner.

Transmetuesi publik izraelit, Kan, publikoi pamje të makinave të përfshira nga zjarri, shtëllunga tymi dhe dritare të thyera nëpër strehimore.

Të paktën gjashtë persona u plagosën lehtë nga sulmet, tha Botner, i cili ishte në grupin e parë të mjekëve të emergjencës që dolën në vendngjarje.

Ushtria izraelite tha se ka kryer disa sulme ajrore gjatë natës në zemër të kryeqytetit iranian, Teheran. Ushtria tha se sulmet shënjestruan objekte për prodhimin e raketave dhe objekte për kërkimin dhe zhvillimin e armëve bërthamore.

## Kasaforta të sigurta që përmbajnë uranium dhe plutonium, brenda bunkerit atomik sekret të Britanisë së Madhe

**LONDËR, 20 QERSHOR** - Kasaforta të sigurta që përmbajnë uranium dhe plutonium të pasuruar dekada më parë janë të shpërndara në të gjithë hapësirën e instalimit të armëve atomike britanike në fshatin Berkshire.

Disa ndodhen nën tokë, brenda ndërtesave të ndërtuara në vitet 1960, të ruajtura nga policia, me patrulla të armatosura me pushkë sulmi C8 Carbine, të përdorura nga Shërbimi Ajror Special (SAS). Kamerat mbajnë roje dhe rojet e sigurisë patrollojnë perimetrin - i rrethuar nga një gardh dhe tela me gjemba, si një burg - dhe 56 qen janë në dispozicion për të nuhatur çdo shenjë të kimikateve toksike. "Rojet dhe armët nuk janë këtu për të na mbrojtur ne, ata janë këtu për ta mbrojtur materialin", tha një nga shkencëtarët që bënte një turne në terren. "Nuk mund t'u afrosh askund [kasafortave] edhe nëse do të përpiqesh", shtoi një tjetër.



Ka masa në fuqi për të siguruar që nëse një aeroplan godet vendin pa dashje, rreziku i një shpërthimi radioaktiv do të minimizohet. Kërcënimi i terroristëve që përpiqen ta vjedhin uraniumin është më i madh se ai i një avioni që bombardon qëllimisht vendin. Është hera e parë në më shumë se një dekadë që gazetarëve u

është lejuar hyrja këtu. Në njërin anë të vendit prej 700 akrash ndodhen oxhaqe të rrënuara që ngrihen mbi një fabrikë "jashtë funksionit" ku dikur pasurohej uraniumi. Për shkak të detyrimeve të saj ndaj traktateve ndërkombëtare, Britania nuk pasuron më materiale. Pasi rezervat e saj të mbarojnë, ato do të riciklohen.

Në këtë vend në fshatin e çuditshëm të Aldermastonit shkencëtarët ekzaminuan çajnikun që përmbante poloniumin vdekjeprurës 210 të përdorur për ta vrarë Alexander Litvinenkon, dezertorin rus, në Londër në nëntor 2006. Rreth 15 miliardë paund po investohen tani në modernizimin e objektit, dikur një bazë ajrore e Luftës së Dytë Botërore dhe tani shtëpia e 9 500 punonjësve - 1 000 më shumë se dy vjet më parë.

Ministria e Mbrojtjes po harton dizajne për gjeneratën e ardhshme të kokave bërthamore sovraane, të njohura si Astraea, dhe fokusi në programin bërthamor të Britanisë po shtohet.

Astraea, e njohur edhe si A21/Mk7, do t'i zëvendësojë kokat bërthamore Holbrook në raketat Trident të vendosura në katër nëndetëset bërthamore të Britanisë. Kanë kaluar dy dekada që kur AWE (Establishmenti i Armëve Atomike) ka punuar me kokat

bërthamore, prandaj vendi ka nevojë për një program të madh investimesh për t'i përgatitur objektet. Astraea po zhvillohet paralelisht me kokën bërthamore W93/Mk7 të ShBA-së, por jo së bashku me ShBA-në, sepse materiali bërthamor nuk mund të transportohet jashtë shtetit.

Plani është që koka bërthamore të jetë gati për përdorim në vitet 2030, megjithëse është ende në fazën e projektimit. Mes paralajmërimeve për një "epokë të tretë bërthamore" në të cilën Britania kërcënohet nga armiq të shumtë, përfshirë Rusinë, shpejtësia do të jetë kritike. "Kjo është një epokë e re kërcënimi dhe ekziston një ndjenjë urgjence. Ne duhet të bëjmë hapa përpara", tha Marina Dawes, drejtoreshë e shkencës në vend. Bombat bërthamore përbëhen nga materiale të zbërthueshme, duke përfshirë uranium, plutonium dhe përbërës të tjerë si eksplozivë të lartë.

## NGA GAZA NË KOSOVË, PËRMES KONTRABANDËS DHE SHPRESËS

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Një migrant palestinez, 27-vjeçar, ka mbërritur ilegalisht në Kosovë, duke përbashkuar rrugë të rrezikshme e kosto të larta. Policia e Kosovës thotë se po forcon kontrollin në kufij me dronë dhe operacione të përbashkëta me shtetet fqinje, për ta ndaluar kontrabandën e migrantëve. Por, sa efektive janë këto masa?

Kur lufta dhe varfëria i detyrojnë njerëzit t'i lënë pas shtëpitë, rrugëtimi drejt një jete më të mirë kthehet në një aventurë të pasigurt dhe me rreziqe.

Husam Nmvawi, nga Rripi i Gazës, pas ecjeve të gjata nëpër male e pagesave prej qindra eurosh, ka përfunduar muajin e kaluar në Kosovë. Teksa rri gjysmë i shtrirë në shtratin e tij në Qendrën për Azil në Magurë të Lipjanit, ai duket se nuk ka një plan të qartë për të ardhmen. "Unë kam qenë fillimisht në Turqi. Prej aty kam paguar 800 euro për të shkuar në Greqi. Nga Greqia, për të kaluar në Shqipëri kam paguar 300 euro", tregon 27-vjeçari.

Rrugëtimi i tij nuk përfundoi aty. Ai do të gjente një mënyrë për të hyrë në Kosovë - pa dokumente dhe pa siguri - ku tashmë ka aplikuar për statusin e azilkërkuetit. "E kam paguar një person 100 euro dhe më ka treguar rrugën. Kam përdorur edhe telefonin", rrëfen Husami për Radion Evropa e Lirë.

Ai nuk dëshiron të zbulojë shumë për rrugëtimin e tij, për grupet që mund ta kenë ndihmuar apo për rreziqet që ka hasur gjatë rrugës. "Kam ecur shumë, edhe nëpër ujë, për të kaluar kufij", thotë me fytyrën ngrysur.

Zëri i zihet edhe më shumë kur përmend Gazën - aty ku thotë se nuk ka më jetë dhe se ikja ishte e vetmja zgjidhje.

Rrëfime si ky marrin edhe më shumë peshë sot, më 20 qershor,

në Ditën Botërore të Refugjatëve, kur bota ndalet për të reflektuar mbi dhimbjen dhe qëndrueshmërinë e miliona njerëzve të zhvendosur. Por, se pse ndodhet pikërisht në Kosovë, Husami nuk e shpjegon qartë. "Për momentin jam duke qëndruar këtu", thotë, dhe nuk tregon nëse Kosovën e ka destinacion përfundimtar apo vetëm ndalesë drejt ndonjë shteti tjetër. Ai përmend shkurt se disa nga të afërmit e tij janë të shpërndarë në shtete të ndryshme evropiane, por nuk thotë nëse ka tentuar të bashkohet me ta.

As autoritetet e Kosovës nuk kanë informacione të qarta për qëllimet afatgjatë të migrantëve si Husami, ndërsa përpunohen të forcojnë kontrollin në kufij - me përdorimin e dronëve dhe me operacione të përbashkëta me shtetet fqinje - për ta ndaluar kontrabandën dhe kalimet ilegale.

Me dronë që patrullojnë ditë e natë, Policia e Kosovës thotë se është duke monitoruar me kujdes brezin kufitar me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut.

Vetëm këtë vit ajo ka ndaluar 15 persona të dyshuar për kontrabandim të migrantëve dhe 13 viktima - rastet e të cilave janë përcjellë nëpër gjykata, ndërsa vitin e kaluar thotë se ka trajtuar rastet e 1 025 migrantëve. "Grupet e tilla i kemi kapur përmes dronëve të natës, kur kemi zhvilluar operacione", thotë për Radion Evropa e Lirë, Nexhmi Krasniqi, drejtor i Departamentit për Kufijtë në veriperëndim të Gjakovës. Ai thekson se pika më kritike në këtë aspekt është zona e Vërmicës, pranë Prizrenit, por shton se muajt e fundit lëvizjet e migrantëve janë reduktuar ndjeshëm falë bashkëpunimit të ngushtë edhe me Policinë e Shqipërisë. "Veç patrullimeve të



përbashkëta mujore që i kemi, ne bëjmë edhe operacione bashkë kur kemi raste të tilla", thotë Krasniqi. Sipas tij, këto rrjete kontrabande janë të përziera dhe udhëhiqen kryesisht nga marokenë e sirianë, me pjesëmarrje edhe të afganëve. Ai thotë se ata përdorin teknologji moderne, si interneti dhe telefonat celularë, për të komunikuar dhe koordinuar lëvizjet, duke i sjellë migrantët nga Greqia, përmes Shqipërisë, në Kosovë, e më pas në Serbi dhe më tej në Evropë.

Disa prej këtyre individëve mund të kenë lidhje edhe me persona nga Kosova, thotë Krasniqi, ndonëse numri i tyre nuk është i madh. "Njerëzit që i kanë ndihmuar kanë qenë pak nga Prizreni, nga Gjilani, Mitrovica... Këta janë të lidhur me ata që kanë kompanitë e veta të taksisë dhe me njerëz që kanë edhe furgonë dhe bëjnë transportin e tyre", shpjegon Krasniqi.

Sipas të dhënave që siguroi Radio Evropa e Lirë nga Policia e Kosovës, migrantët e ndaluar në Kosovë janë kryesisht nga Maroku, Siria, territoret palestineze, Egjipti dhe vende të tjera. Ata hyjnë në Kosovë nga të gjitha vendet me të cilat kufizohet, e sidomos nga kufiri

me Maqedoninë e Veriut dhe me Shqipërinë.

Por, lufta kundër kontrabanduesve nuk mbyllet me aksionet e policisë. Në këtë proces janë të angazhuara edhe institucionet e drejtësisë që synojnë goditjen e rrjeteve kriminale.

Prokuroria Themelore në Prizren - një prej komunave më kritike për kontrabandimin e migrantëve - bën me dije për Radion Evropa e Lirë se gjatë viteve të fundit ka trajtuar një numër të konsiderueshëm rastesh, me mbi 30 lëndë të hapura dhe dhjetëra persona të përfshirë, ndërsa në vitin 2025, deri më tani, nuk është pranuar asnjë rast i ri. "Në vitin 2022 kjo prokurori ka pranuar 13 lëndë ndaj 48 personave, ka kryer 19 lëndë ndaj 46 personave dhe ka ngritur aktakuzë në 13 lëndë ndaj 31 personave. Në vitin 2023 janë pranuar 3 lëndë ndaj 13 personave dhe janë kryer 3 lëndë ndaj 32 personave. Në vitin 2024 janë pranuar 3 lëndë ndaj 4 personave, është kryer 1 lëndë ndaj 9 personave dhe është ngritur aktakuzë ndaj 8 personave pas hetimeve", thuhet në përgjigjen e Prokurorisë Themelore në Prizren, dërguar Radios Evropa e Lirë.

Aktualisht në Qendrën për Azil

në Magurë janë të strehuar 17 migrantë, ndërsa në Qendrën për Migrantë në Vranidoll janë 9. Fitim Zariqi, drejtor i Qendrës për Azil në Magurë, thotë për Radion Evropa e Lirë se, ndryshe nga vitet e mëparshme, këtë vit është shënuar rënie e numrit të personave të strehuar në këtë qendër.

"Nga janari i këtij viti e deri më tash kemi pasur 44 aplikues për mbrojtje ndërkombëtare. Disa nga ta janë larguar. Siç dihet, Kosova - në shumicën e rasteve - shfrytëzohet si vend transit për migrantë dhe nuk qëndrojnë këtu. Shumica janë larguar, kurse tani kemi vetëm 17 persona", thotë Zariqi.

Ai tregon se nga viti 2019 - kur në Kosovë kanë aplikuar për azil 2 081 persona - numri i tyre ka shkuar duke rënë: në vitin 2020 kanë qenë 1 409; më 2021 - 578; më 2022 - 550; më 2023 - 181; më 2024 - 190 dhe deri më tash këtë vit 44.

Sipas rregullave në Kosovë, një migrant mund të qëndrojë në vend vetëm 15 ditë pa u lajmëruar tek autoritetet e rendit. Pas 15 ditësh, ai duhet të aplikojë për statusin e azilkërkuetit - në të kundërtën duhet të largohet nga territori i Kosovës.

Kosova nuk ka marrëveshje ekstradimi me shumë shtete dhe migrantët nuk mund të dëbohen, por shumica, thonë autoritetet, ikin vetë. Sipas tyre, migrantët që nuk synojnë të qëndrojnë në Kosovë zakonisht ndalojnë për 3 deri në 7 ditë, ndërsa për ta fituar statusin e azilit atyre u duhen disa muaj kohë.

Kosova, edhe pse nuk është pjesë e Bashkimit Evropian dhe përballet me sfida socio-ekonomike, ka pranuar dhe strehuar qindra azilkërkuetit vitet e fundit, veçanërisht gjatë krizave humanitare si ajo në Afganistan apo Ukrainë.

## SAMITI NË HAGË PRITET TA KONFIRMOJË SHQIPËRINË MIKPRITËSE TË SAMITIT TË NATO-S MË 2027

TIRANË, 20 QERSHOR - Samiti i javës së ardhshme në Hagë pritet ta konfirmojë Shqipërinë mikpritëse të Samitit të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior, NATO, në vitin 2027.

Drafti i deklaratës së Samitit të sivjetshëm të NATO-s, të cilin e ka parë Radio Evropa e Lirë, konfirmon se Shqipëria do të jetë nikoqire më 2027.

Samiti i sivjetshëm i NATO-s mbahet në Hagë të Holandës javën e ardhshme, ndërsa ai i vitit 2026 do të mbahet në Turqi.

Në fund të draftit të deklaratës thuhet: "Ne shprehim mirënjohjen tonë për mikpritjen e xhymert nga Mbretëria e Holandës. Mezi presim takimin tonë të ardhshëm në Turqi më 2026, i cili do të pasohet nga një



takim në Shqipëri". Sipas draftit të deklaratës, udhëheqësit e NATO-s riafirmojnë angazhimin për mbrojtje kolektive sipas Nenit 5

dhe vendosmërinë për t'i mbrojtur qytetarët dhe demokracinë. Ata zotohen për rritjen e shpenzimeve në mbrojtje në të paktën 5 për qind

të PBB-së deri në vitin 2032 - 3.5 për qind për kapacitetet ushtarake dhe 1.5 për qind për infrastrukturën kritike, inovacionin dhe industrinë e mbrojtjes.

Mbështetja për Ukrainën mbetet e fortë dhe do të përfshihet në llogaritjet e shpenzimeve të mbrojtjes. Aleanca angazhohet, gjithashtu, ta forcojë industrinë e përbashkët të mbrojtjes, t'i heqë barrierat tregtare dhe ta promovojë bashkëpunimin teknologjik mes aleatëve, sipas draftit të deklaratës.

Kryeministri shqiptar, Edi Rama, i cili muaj më parë e fitoi mandatin e katërt, kishte paralajmëruar verën e kaluar se Shqipëria do ta mirëpriste Samitin e NATO-s më 2027. Kryeqyteti shqiptar, Tirana, ishte

mikpritës i një takimi të rëndësishëm këtë vit, pasi mblodhi liderët e mëdhenj evropianë për Samitin e Komunitetit Politik Evropian në maj.

Shqipëria është pjesë e NATO-s që nga viti 2009 dhe kjo do të jetë hera e parë që ajo mirëpret samitin.

NATO-ja e ka një bazë ajrore në Shqipëri, përkatësisht në Kuçovë, të vetmen në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ajo është përfunduar në mars 2024, pasi NATO-ja investoi afërsisht 50 milionë euro në të, ndërsa qeveria shqiptare shpenzoi më shumë se 5 milionë euro. Shqipëria është në bisedime me NATO-n edhe për ndërtimin e një baze detare në Porto Romano në bregdetin e Adriatikut.



# QEVERIA E KOSOVËS SYNON T'I NDËRTOJË DY URA TË REJA PRANË URËS KRYESORE MBI IBËR NË MITROVICË

Synimi për ndërtimin e këtyre dy urave vjen disa ditë pasi Mitrovica - qyteti i ndarjes më të theksuar etnike në Kosovë - themeloi Bordin e Përbashkët në mes të komunës jugore me shumicë shqiptare dhe asaj veriore me shumicë serbe. Lëvizja Vetëvendosje, e udhëhequr nga kryeministri në detyrë Albin Kurti, ka publikuar një fotografi e cila tregon se si do të dukeshin këto dy ura. Ato do të ndërtoheshin në anën e majtë dhe të djathtë të urës kryesore

**PRISHTINË, 20 QERSHOR** - Qeveria në detyrë e Kosovës synon t'i ndërtojë dy ura në të dy krahët e urës kryesore mbi lumin Ibër, të cilat do ta lidhnin Mitrovicën Veriore të banuar me shumicë serbe me Mitrovicën Jugore të banuar me shumicë shqiptare. Synimi për ndërtimin e tyre vjen disa ditë pasi Mitrovica - qyteti i ndarjes më të theksuar etnike në Kosovë - e themeloi Bordin e Përbashkët në mes të komunës jugore dhe asaj veriore. Themelimi i bordit u përshëndet nga qeveria në detyrë e vendit, ashtu si edhe nga dy komunat të cilat e kanë cilësuar si mundësi për të sjellë projekte të përbashkëta, që përmirësojnë jetën e qytetarëve në të dyja anët e lumit Ibër. Lëvizja Vetëvendosje, e udhëhequr nga kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, publikoi një fotografi e cila tregon se si do të dukeshin këto dy ura. Siç shihet në fotografitë e publikuara, urat e reja do të ndërtoheshin në anën e majtë dhe të djathtë të urës kryesore, e cila është pjesë e Marrëveshjes midis Kosovës dhe Serbisë për

lirinë e lëvizjes, të arritur në Bruksel si pjesë e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. "Ky projekt do ta lehtësojë lëvizjen e qytetarëve dhe do të shërbejë si një infrastrukturë për komunikim, integrim dhe zhvillim midis dy pjesëve të qytetit", sipas njoftimit të Vetëvendosjes më 19 qershor. Një ditë më parë ministri në detyrë i Infrastrukturës, Liburn Aliu, njoftoi se nënshkroi një "memorandum për mbështetje të projekteve të infrastrukturës midis Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të dy komunave, për një qytet më të lidhur, funksional dhe më të mirë për të gjithë qytetarët", me kryetarin e komunës së Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq dhe nënkryetaren e komunës së Mitrovicës së Jugut, Ariana Tahiri, në prani të ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi. Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar, reagoi një ditë më parë, ndër të tjera, edhe lidhur me ndërtimin e këtyre dy urave, duke thënë se

Kurti "po e zbaton me shpejtësi dhe pa asnjë fshehje planin për spastrim etnik të popullit serb nga territori i Kosovës". Ura kryesore mbi Ibër, e cila e ndan Mitrovicën në pjesën jugore me shumicë shqiptare dhe pjesën veriore me shumicë serb, është e hapur vetëm për këmbësorët. Njoftimi i Qeverisë së Kosovës në korrik të vitit të kaluar planifikon ta hapë këtë urë për trafik ngriti tensione dhe shkaktoi reagime nga bashkësia ndërkombëtare. Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, është i vendosur në këtë urë. KFOR-i i tha Radios Evropa e Lirë

asokohe se çdo vendim për hapjen e urës duhet të merret brenda kornizës së dialogut Kosovë - Serbi i cili zhvillohet përmes Bashkimit Evropian. Ata deklaruan se NATO e mbështet këtë dialog dhe se KFOR-i është aty për të kontribuar në një mjedis të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme. "Kjo përfshin një prani të përhershme në urën në Mitrovicë dhe patrullime të rregullta në zonën përreth", tha KFOR-i. Bashkimi Evropian, gjithashtu, kujtoi se çështja e hapjes së urës ishte tema e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë për

normalizimin e marrëdhënieve dhe se për këtë arsye të gjitha vendimet duhet të merren brenda dialogut me pjesëmarrjen e delegacioneve zyrtare të Prishtinës dhe Beogradit.

## Kronologjia e zhvillimeve rreth urës

Pas luftës së viteve 1998/'99 kjo urë e ndau qytetin e Mitrovicës në pjesën jugore me shumicë shqiptare dhe në atë veriore me shumicë serbe. Plani i Ahtisaarit - baza mbi të cilën Kosova e shpalli pavarësinë e saj më 2008 - parashikoi ndarjen e Mitrovicës në dy komuna të veçanta. Më 2011 serbët lokalë vendosën aty barrikatadë e para, për ta kundërshtuar shtrirjen e autoriteteve të Kosovës. Më 2013 u formua komuna e Mitrovicës së Veriut, sipas ligjeve të Kosovës. Më 2014, barrikatadë u zëvendësuan me copa betoni dhe me pemë. Pamja e re u quajt "Parku i Paqes". Po atë vit, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje në Bruksel për heqjen e barrikadave dhe për rivitalizimin e urës. Më 2015 u hoq Parku i Paqes, me idenë e hapjes së urës për qarkullim. Më 2016, palët në Bruksel u pajtuan për një plan zbatimi të marrëveshjes për urën. Rivitalizimi i urës u përfundua nga Bashkimi Evropian më 2018 dhe kushtoi rreth 1.5 milion euro. Aktualisht, ura mbetet e hapur për këmbësorë, por jo edhe për automjete.



DY URA TË REJA MBI LUMIN IBËR QË LIDHIN JUGUN DHE VERIUN E MITROVICËS

## Sondazhi i UBO Consulting: LV-ja fajësohet 32.6 % për bllokadën në Kuvend, pasuar nga PDK-ja

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Është publikuar sondazhi i fundit i realizuar nga UBO Consulting, i cili mat perceptimin e qytetarëve për krizën politike dhe bllokadën që po ndodh në Kuvendin e Kosovës.

Në pyetjen: "Kush mendoni se është fajtori kryesor për bllokadën që po vazhdon në

Kuvendin e Kosovës?", shumica e të anketuarve kanë fajësuar të gjitha partitë politike.

Sipas rezultateve: 32.6 % fajësojnë Lëvizjen Vetëvendosje. 7.2 % mendojnë se përgjegjëse është Partia Demokratike e Kosovës (PDK), 6.3 % fajësojnë Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK),

1 % e konsiderojnë përgjegjëse Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), 3.1 % e të anketuarve nuk kanë një përgjigje.

Ndërkaq në aspektin e përgjithshëm, 49.9 % e qytetarëve vlerësojnë se krejt partitë e kanë përgjegjësinë.

Sondazhi është realizuar mbi



një mostër përfaqësuese prej 1 065 qytetarësh, me një interval besueshmërie prej 95 % dhe

marginë gabimi ±3 %. Matja është kryer në periudhën 9-18 qershor 2025.

## HARADINAJ PARALAJMËRON KURTIN: BOLL ËSHTË BOLL! DO TË KENI PASOJA NËSE NUK NDALENI SË BLOKUARI VENDIN



PRISHTINË, 20 QERSHOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se kriza politike për formimin e institucioneve është si pasojë e qasjes së kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. Sipas tij, kjo që është duke ndodhur me vendin shkakton pasoja të rënda.

Haradinaj ka paralajmëruar se nuk do të lejojnë që Kurti dhe bashkëpartiakët e tij të bëjnë hajgare me vendin. "Mos ta vazhdojë këtë gjendje kështu, se nuk do t'i shkojë kështu. Unë po i them seriozisht edhe atij (Kurtit) edhe asaj kandidates (Haxhiu), mos e vazhdoni më kështu, se nuk ka me ju shkuar më kështu. Keni me ia pa sherrin edhe personalisht, se nuk lejojmë me ba hajgare me vendin pakufi. Boll është boll! E keni tepruar. Ndaluni! Ose kthjelluni ose do të ballafaqoheni. Ka pasur edhe të tjerë sikur këta që kanë menduar se janë të paprekshëm, sikur e kanë prekur zotin me dorë, mirëpo

populli i ka do rregulla të veta dhe njerëzit i kanë do rregulla të veta. Duke e ndryshuar gjendjen shumë herë në vend, e ndryshojmë edhe me këtë", ka thënë Haradinaj për "RTV21". Më tutje, Haradinaj nuk ka përjashtuar edhe aksione simbolike ndaj Kurtit. "Ne është mirë të fillojmë t'ia nxijmë jetën këtij njeriu. Me ia bërë të mundshme mbajtjen peng të Kosovës në mënyrën se si po e mban që ai me shkuar në qeveri në mënyrë ilegale, se ai e ka dhënë betimin në Parlament. Me ardhë në Parlament me bërë hajgare. Na duhet me filluar me ia kthyer diqysh këtij njeri. Atë nuk është mirë me lënë me dalë as në rrugë. Duhet me ia kthyer vezët që na gjujke, duhet me ia kthyer gazin që na gjujke, duhet me ia kthyer të gjitha e mi thënë zotni nuk mundesh me mbajtur peng vendin se nuk është ky vend jetim. Ose kryejë detyrat në bazë të Kushtetutës mos humb kohë duke na thirr çdo të dytën ditë në Kuvend. Ose ikë lësho rrugë ose ta bëjmë qarën", ka thënë Haradinaj.

## Kurti takon ambasadorin Çobaj e Malaj, temë diskutimi forcimi i raporteve

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Kryeministri në detyrë Albin Kurti u takua të premten me ambasadorin e Malit të Zi në Kosovë, Bernard Çobaj, me të cilin biseduan për zhvillimet në vend, marrëdhëniet bilaterale dhe bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Ndër të tjera, u theksua rëndësia e diplomacisë kulturore në thellimin e marrëdhënieve ndërmjet vendeve.

Kryeministri falënderoi ambasadorin Çobaj për përkushtimin dhe angazhimin në forcimin e raporteve dypalëshe dhe për mbështetjen e vazhdueshme të Malit të Zi ndaj Kosovës.

Kurti po të premten ka takuar edhe ambasadorin e



Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj. Diskutuan për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në fusha të ndryshme, duke përfshirë ekonominë, infrastrukturën, sigurinë dhe fusha të tjera në kuadër të të cilave tashmë po zbatohen

marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Të dy shprehën përkushtimin për t'i avancuar marrëdhëniet dypalëshe, duke punuar ngushtë për projekte të



përbashkëta që do të sjellin përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët e të dy vendeve. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për zhvillimet e fundit në vend, përfshirë procesin e konstituimit të Kuvendit dhe formimin e institucioneve të

legjislaturës së nëntë. Kryeministri Kurti falënderoi ambasadorin Malaj për angazhimin e tij të vazhdueshëm për shtimin e lidhjeve dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

## TRE LUGETËR PARA VARRIT TË ADEM DEMAÇIT



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Nuk ka turp pa adresë:** Njeri si Bacë Adem Demaçi nuk i përkasin vetëm kohës kur ka jetuar, nuk i përkasin vetëm popullit që i kanë takuar; janë vlera, ndërgjegjja e tërë njerëzimit. Liria nuk është diçka që i takon vetëm një individi, vetëm një kombi por mbarë njerëzimit. Nga përkushtimi për të qenë i lirë, për ta mohuar robërinë, kryesisht fizike përmes sakrificës së përhershme, të përjetshme lindin personalitete që i japin kuptim dinjitetit kolektiv duke mohuar vuajtjet personale. Nuk ka shumë personalitete të tilla në botë që mbijetojnë kohën që matet me dekada dhe shekuj e që janë hiçgjë krahasuar me përjetësisë për të cilën nuk ka njësi matëse kohore. Njëri ndër margaritarët e angazhimit për liri gjatë tërë jetës së tij ishte Baca Adem Demaçi, për shokët, miqtë, bashkëveprimtarët dhe bashkëluftëtarët në Rrugën e Golgotës për

shqiptarët e robëruar dhe thjesht Adem Demaçi si një emër abstrakt për mohuesit, dhunuesit dhe robëruesit e shqiptarëve dhe të vet atyre. Baca Adem Demaçi nuk kishte llogari matëse për jetëgjatësinë e tij sepse nuk bënte llogari sa do të jetojë dhe si do të jetojë, por çka dhe sa do të bënte për popullin që e lindi dhe njerëzimin e robëruar që iu bë djep, shtrat dhe pedestal për së gjalli dhe amshim pasi u transformua nga fizikja në shpirtërore më 26 korrik 2018. Herkuli ishte mit, Titani ishte mit, Goliati ishte gjithashtu mit, Baca Adem Demaçi ishte realitet, ishte përfytyrim i lirisë për dikë të mohuar, për tjetrin të sajuar. Të tillët nuk i duron koha e trutharëve, tyxharëve, qyqarëve, zuzarëve dhe tradhtarëve që ishin ushtarë të robërisë, të Jugosllavisë dhe Serbisë, deri dje kurse sot të Çetës së Injorantëve, pushtet dhe jopushtet, lehtësisht të identifikueshëm në ligatinën antikombëtare. Të tillët e madhëruan Bacën Adem Demaçi, deri erdhën në pushtet, e sulmuan dhe e harruan kur shtetin e bënë pushtet! U munduan ta ndërrojnë adresën e turpër duke vendosur maska për vete dhe duke çjerrë maska që në të vërtetë ishin pafytyra të identifikueshme, me emër dhe mbiemër, adresë banimi dhe adresë mohimi.

**Po Baca, ç'bëri?:** Asgjë përveç se u bë pengesë e pakapërcyeshme për të uriturit e pangopshëm për pushtet të cilët nuk kishin bërë asgjë për shtet, personalisht dhe familjarisht. Kur ishte në pyetje interesi njerëzor, kombëtar dhe shtetëror Baca u bë me të gjithë dhe kundër të gjithëve, shtrojë dhe mbulojë, cak për gjuajtje dhe pushkatim publik, arsytues i horrave, shkaktues i plagëve dhe mbulues i vragëve. Jashtë çdo mase ka duruar, asnjëherë i nënshtruar. U akuzua se është komunist, enverist, maoist, leninist, stalinist dhe titist nga ata që ishin jarga e tyre, pëshytma e tyre, zorrë e trashë e tyre dhe kanalizim i tyre, dikur në pushtet, sot në "pushtet". Nga përkufizimi i vërtetë dhe i drejtë Baca Adem Demaçi ishte njeri i lirë i botës dhe rob i popullit që i takoi. Ideologjia e tij politike ishte kombëtarja dhe vetëm kombëtarja. Baca kurrë nuk i ka kënduar as Enverit e as Beterit, as Partisë së Punës dhe Nënës Parti, por i ka kënduar Dedë Gjo Lulit, Mehmet Shpendit, Kamer Loshit dhe Nënës Shqipëri, me Kosovë dhe Çamëri!

**Po shqiptarët dhe "shqiptarët":** Askush nuk është sulmuar dhe mohuar më shumë se Baca

Adem Demaçi, sa ishte në "liri" dhe sa ishte në robëri. E pushkatuan publikisht Marku, jo Kraveviqi por Krasniqi, Ismajli, jo Kosumi, por Kadare, Vetoni, jo Firzi, por Surroi. E përdornin për të ardhur në pushtet duke e penguar pozita në shtet, as president, as kryekuvendar, as KM, as ministër e as deputet. Në mesin e iskariotëve refuzues dhe pengues ishte vet Juda-Albin Kurthi për të cilin Baca bëri më shumë se për të gjithë të tjerët. Pak shokë i mbetën Bacës afër kur pasuli hahej me kokrra, kur vdekja ishte në vend të këmishës, sidomos kur u prekë nga sëmundja. Ia improvizuan funeralin dhe varrimin sikur varrimi i Mocartit, sikur ta bënin shërbimet sociale. Edhe në ato çaste përfitues me anatomi njerëzore e instikt të hienave donin ta nduknin lavdinë e tij për ta mbuluar palavdinë e tyre. Vizitat e bartësve të posteve institucionale te Vendi i Përjetësisë së Bacës nuk ishin shprehje e respektit ndaj jetës dhe veprës së Bacë Adem Demaçit, por materializim i përfitimeve politike të kushtëzuar; unë vijë te Rugova, t'i vjen te Adem Demaçi, një udhë e dy punë, në fund të fundit Baca dhe Rugova janë afër. Kjo, në fakt është mungesë e respektit, pafytyrësi dhe imoralitet,

perversitet dhe sadizëm. Vizita e fundit e trojkës antidemaçiane; Albin Kurthi, Xhelal Sveçla dhe Marimanga e Zezë - Donika Shvarc paraqet shkelje të rëndë të parimit moral minimal për ata që e kanë ndjenjën e turpër dhe të përgjegjësisë. Për respekt as që bëhet fjalë. Nëse Albin Kurthit i ka mbetur një milimetër fytyrë që e arsyeton vizitën e Vendi të Përjetësisë së Bacës Adem Demaçi, me çfarë të drejtë ishte aty Xhelal Sveçla e sidomos Marimanga e Zezë - Donika Shvarc. Nëse e keni ruajtur fytyrën reale anatomike, nuk mund të shkoni te Baca Adem Demaçi kur e keni sulmuar UÇK-në, kur i përndiqni të burgosurit politikë, kur bëheni miq të Gjykatës Raciste Speciale kundër udhëheqësve të UÇK-së, kur ua dhunoni të drejtat veteranëve dhe invalidëve të luftës, kur dërgoni "dëshmi" dhe dëshmitarë te kjo gjykatë dhe shumë kur të tjera. Nëse i dhunoni të gjallët që janë me Bacën, për së gjalli dhe kur është në amshim, mos i trazoni varret e shenjta për ne, kalkuluere për juve që asgjë nuk bëtë për lirinë, kombin dhe shtetin. Nuk ka gjë më poshtëruese se kur Marimanga e Zezë - Donika Shvarc shkon te Vendamshimi i Bacë Adem Demaçi. A e kemi merituar këtë?

## OWADA: AJO QË ËSHTË ARRITUR NË KOSOVË ËSHTË TRIUMF NJERËZOR



**PRISHTINË, 20 QERSHOR** - I nderuari me titullin "Doctor Honoris Causa" nga Universiteti i Prishtinës, ish-kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në kohën kur kjo gjykatë lëshoi opinionin se pavarësia e Kosovës, e shpallur në vitin 2008, nuk i ka shkelur ligjet

ndërkombëtare, Hisashi Owada, ka thënë se ajo që është arritur në Kosovë është triumf njerëzor, e jo fitore ndërmjet kombeve. Juristi i njohur globalisht i së drejtës ndërkombëtare, tash me titullin më të lartë të nderit nga UP-ja, ka mbajtur ligjëratë me temën "Përse luftë - një

reflektim mbi rendin publik të komunitetit ndërkombëtar". "Profesor Hisashi Owada e konsideroi dëshirën për pushtet, të vendosur thellë në mendjen njerëzore, si njëri nga forcat që pengojnë përpjekjet për paqe. Profesori i nderuar duke kujtuar dialogun e viteve '30 mes fizikanit Albert

Einstein dhe psikoanalistit Zigmund Freud për problemet më të theksuara të njerëzimit, konstatoi se gjërat edhe sot nuk kanë ndryshuar aq shumë që nga ajo kohë", është thënë në njoftimin e shpërndarë nga Universiteti i Prishtinës. Kjo ligjëratë, sipas UP-së nga profesori Owada, është

përmbyllur me konkludimin se nuk është pesimist, meqenëse njerëzimi gjatë historisë ka arritur rezultate dhe ka mësuar nga gabimet. Owada ka falënderuar Universitetin e Prishtinës për nderimin që iu bë dhe të gjithë personat që ndihmuan një proces të tillë.

# PDK-JA ËSHTË MODEL I DEMOKRACISË INSTITUCIONALE



Prof. dr. Agim ZOGAJ

Një prej çështjeve thelbësore në zhvillimin, reformimin e partive bashkëkohore politike është forcimi i demokracisë së tyre të brendshme, pra fuqizimi i demokracisë brenda partiake. Vetëm ato parti politike, të cilat, në politikën e tyre publike i respektojnë, i afirmojnë standardet e demokracisë partiake, mbi parimet e qytetërimeve euro-perëndimore, vetëm ato, siç është rasti me PDK-në, mund të reflektojnë, demokraci në jetën shoqërore, politike, parlamentare. Pra, përgjithësisht, demokraci për

popullin, për qytetarin, demokraci, e cila, do të jetë në shërbim të sistemit të vlerave shoqërore dhe politike. Partia Demokratike e Kosovës, si bashkim kolektiv, vullnetar i ideve, e cila, që nga themelimi i saj, vepron jo për pushtet, por për shtet, për Kosovë, është prijatë në inaugurimin e demokracisë pluraliste, qytetare dhe parlamentare. Demokracia politike, parlamentare, të cilën sot e kultivon PDK-ja, është model institucional për jetën politike, qeveritare dhe parlamentare në Kosovë. Pavarësisht, nga kjo histori e ndritshme e demokracisë dhe e kulturës politike, reformatore të PDK-së, e inauguruar si vlerë, si qytetërim, dje, me kryetarët, Thaçi dhe Veseli, sot me Kryetarin reformatör, z. Krasniqi, PDK me guxim aspirojnë zgjerimin e kufijve të demokracisë pjesëmarrëse. Sot, në zhvillimet aktuale politike, shoqëroren nëpër të cilat po kalon Kosova, na duhet

vullnet, unitet dhe moral i ri politik që, proceset e shtrirje së demokracisë partiake, veçmas të demokracisë parlamentare, të kulturës politike, të komunikimit, t'i avancojmë, përmes emblemës së PDK-së. Kjo nënkupton, gjithnjë e më tepër, dialog përmbytësor me anëtarësinë, debat të brendshëm, për politikën publike të PDK-së, për format, mënyrat më të suksesshme dhe më demokratike, për çështjet me interes nacional, për ndërtimin e sistemit të ri të vlerave shoqërore, sepse, PDK është parti shtetformuese. Ndërkohë, në të gjitha nivelet e organizimit të jetës politike, partiake, PDK, po krijon hapësirë për ide të reja, ide reformatore, për koncepte bashkëkohore të politikëbërjes, emancipimit politik e kulturor, mbi të gjitha, intelektualizimin e jetës partiake. Në këtë kuptim, PDK, edhe në nivel kombëtar, është model i politikëbërjes demokratike, sepse, sipas

filozofisë politike të PDK-së, pushteti, qeveria, parlamenti duhet të jenë në shërbim të qytetarit.

## Kultura e dialogut dhe pluralizmi politik

Me këtë qasje, demokratike, ashtu siç, përherë, e vë në pah, kryetari i PDK-së, z. Memli Krasniqi, ne, e begatojmë kulturën politike, kulturën e dialogut, pluralizmin, tolerancën politike në mendimet, pikëpamjet, për dhe kundër, e përparojmë, nivelin e ri të emancipimit shoqëror, kulturor, jo vetëm të anëtarësisë së PDK-së, por të shoqërisë mbarë. Demokracia brenda partiake në PDK, siç dëshmon historia e sukseseve të PDK-së, nënkupton krijimin e hapësirës, të ambientit politik në të cilin, demokracia e shumicës garanton respektimin e mendimit të pakicës, për më tepër, siç janë përvojat e PDK-

së, krijojnë tolerancë ndaj mendimit ndryshe dhe e kundërshtojnë, e përjashtojnë dogmatizimin e mendimit politik, partiak. Në këtë mënyrë, me një vizion modern politik të PDK-së, po ia dalim me sukses, që të jemi shembull i kulturës politike, në jetën shoqërore, parlamentare në Kosovë. Gjithsesi, edhe në ballafaqimet politike të radhës, PDK, do të jemi forcë politike avangardë, më e besuara për zgjedhësit, do të jemi fitimtar, sepse, në këtë kohë, fitorja e PDK-së, është alternativa jonë e vetme dhe e Kosovës mbarë! Sërish, sikur dikur, dritaret e një të sotme prosperuese për Kosovën, mund t'i hap, vetëm PDK-ja, sepse, PDK, është vlerë, është ndërgjegje, krenari kombëtare, është djepi i shtetit, i themelimit, i faktorizimit të Republikës së Kosovës!

**\*Autori është anëtar i Këshillit Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës**

## KMDLNJ: FADIL FAZLIUT PO I MOHOHET MBROJTJA NË HAGË

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNJ) ka vlerësuar se Fadil Fazliut është duke iu bërë padrejtësi nga Gjykata Speciale meqë, sipas këtij këshilli, nuk po i lejohej të ketë mbrojtës avokatin të cilin ai po e kërkon. "Fadil Fazliu, si i arrestuar këmbënguli që Artan Qerkini të jetë avokat mbrojtës bashkë me një avokat ndërkombëtar e që Gjykata Speciale bëri përpjekje ta pengojë me të gjitha mjetet e lejuara e sidomos të palejuara, ku konfliktin e interesit e përdori si 'argument' kryesor për ta pamundësuar mbrojtjen efektive, të garantuara me të gjitha dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria", është thënë në reagimin e KMDLNJ-së. Më tutje, ky këshill ka thënë se Artan Qerkini i ka fituar disa raste para Gjykatës Kushtetuese të kësaj Gjykate sikur që ka fituar, sipas tyre, pafajësinë, gjithashtu në disa raste për të mbrojturit e tij. "Shkeljet e identifikuar nga avokati, Artan Qerkini nuk janë identifikuar nga asnjë mbrojtës e as nga i ashtuquajturit Avokat i Popullit i Gjykatës Speciale në Hagë. I akuzuari Fadil Fazliu këmbëngulë që për mbrojtës ta ketë avokatin Artan Qerkini, sikur edhe familja e tij, Gjykata Speciale e pamundëson këtë duke shkelur brutalisht të drejtat e personit të akuzuar



për një proces të drejtë, fer, të pavarur, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht dhe nga grupet e interesit. Është e drejtë elementare e njeriut për një të akuzuar që të përcaktohet për avokatin mbrojtës në të cilin ka fituar besimin dhe ia ka dhënë besimin. Nëse pamundësohet bashkëpunimi midis të akuzuarit dhe avokatit për të cilin përcaktohet në bazë të

vullnetit dhe besimit, në asnjë mënyrë nuk mund të flitet për një mbrojtje efektive", është thënë në reagimin e KMDLNJ-së. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNJ) ka thënë se e kundërshton këtë vendim, siç e kanë quajtur ata, përjashtues kundër avokatit Artan Qerkini dhe Fadil Fazliut, si shkelje

brutale e të drejtave të njeriut, shkelje flagrante të etikës profesionale dhe paragjykim të parimit të prezumimit të pafajësisë. "Në kohën kur ligjet dhe Kushtetuta e Kosovës shpërfillen skajshmërisht, nuk tregohet as respekt minimal për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila gjithashtu dhunohet brutalisht. Standardi më i lartë

i Kombeve të Bashkuara për persona të privuar nga liria, të njohura si rregullat e Nelson Mendeles, me të cilat mburret se i zbaton kjo gjykatë në Hagë, në rastin konkret dhe të tjera i ngjajnë një karikaturë të mbështjellë me një cipë 'demokratike', ndërsa brenda është e mbushur me një shëmti juridike", është thënë në reagimin e KMDLNJ-së.

## Hoti: Kriza energjetike po e rrënon ekonominë

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se kriza energjetike po e rrënon ekonominë e Kosovës. Ai ka thënë se investimet aktuale dhe të ardhshme do të ndikohen negativisht nga mungesa e qartësisë sa i përket furnizimit me energji. "Paqartësia nuk lidhet vetëm me çmimin e lartë dhe të paparashikueshëm, por edhe me pasigurinë e furnizimit. Asnjë masë nuk është marrë

tash e sa vite. Blloqet e termocentraleve Kosova A dhe Kosova B vazhdojnë të bien nga sistemi, pasi tenderët për rinovim e mirëmbajtje vonohen me vite. Centrali me gaz i Marrëveshjes së Uashingtonit u anulua në vitin 2021. Mjetet e parapara për atë qëllim u destinuan për projektin e baterive, por në fund humbën krejtësisht për shkak të ndryshimit të prioritetëve të politikave

amerikane", ka thënë Hoti. Ai ka theksuar se dalja në tregun e hapur energjetik, pa i siguruar kushtet paraprake, duket se do të jetë shkatërruese për shumë prodhues. "Kjo do të ketë pasoja për punësimin e mijëra punëtorëve dhe, në veçanti, do t'i përkeqësojë aftësitë konkurruese të prodhuesve të Kosovës në tregun vendor dhe të jashtëm, duke e thelluar edhe më tej deficitin tregtar të Kosovës", ka thënë Hoti.



## NGA VITI 2017-2023 JANË RRITUR TË HYRAT NË SEKTORIN E TURIZMIT TË HOTELERISË DHE GASTRONOMISË

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Në Konferencën për Zhvillimin e Turizmit, të mbajtur me ekspertët, bizneset dhe institucionet qendrore dhe lokale, u diskutuan arritjet e projektit Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE). Ky projekt mbështetet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim dhe implementohet nga Swisscontact në Kosovë dhe Instituti Riinvest.

Fokus i konferencës ishte orientimi që duhet të marrë turizmi për një zhvillim sa më të qëndrueshëm, por edhe ekonomikisht të favorshëm për komunitetet lokale.

Menaxherja e projektit PPSE nga Swisscontact, Blerina Batusha Xërxa, tha se projekti ka qenë i përqendruar në rritjen e të ardhurave dhe të vendeve të punës në Kosovë. "Projekti ynë gjatë kësaj periudhe 12-vjeçare ka qenë i fokusuar për të rritur numrin e vendeve të punës si dhe të hyrave për komunitetin në sektorin e ushqimit dhe turizmit. Një mësim për projektin tonë ka qenë që sukcesi mund të arrihet, transformimi mund të arrihet kur punojnë të gjithë së bashku dhe i shohim cilat janë sfidat dhe nevojat e komunitetit lokal dhe si mund t'i adresojmë këto bashkërisht", theksoi



menaxherja e projektit PPSE. Lumturije Geci nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë theksoi se synojnë që Kosovën ta bëjnë një destinacion konkurrues të turizmit në rajon. "Vizioni është i qartë. Duhet ta zhvillojmë një turizëm të qëndrueshëm dhe kjo ndërthen në vete një sfidë sepse duhet të kemi parasysh

shumë aspekte sepse jemi në fillim dhe mund të jetë sfiduese për ne. Me qëllim që të zhvillojmë këtë turizëm, po synojmë që përmes strategjisë së turizmit Kosova të bëhet një destinacion konkurrues në rajon", tha Geci. Teuta Hoxha Jahaj nga PPSE në prezantimin e saj u përqendrua në rritjen e numrit të turistëve

në Kosovë ndër vite, duke listuar faktorët që kanë ndikuar në këtë rritje. "Projekti ynë kishte për qëllim sjelljen e sa më shumë turistëve në Kosovë. Të hyrat nga turizmi janë rritur ndjeshëm. Nga viti 2017-2023 janë rritur për 300 % të hyrat në sektorin e turizmit të hotelerisë dhe gastronomisë. Një tjetër aspekt pozitiv i rritjes së numrit

të turistëve është edhe rritja e operatorëve turistikë", shtoi Hoxha Jahaj.

Ndërkaq pjesa e dytë e prezantimit i takoi Lulzim Krasniqi, po ashtu pjesë e ekipit të PPSE-së, i cili ndau ekspertizën e tij në këtë projekt. "Një element i rëndësishëm është edhe transporti ajror i cili është përmirësuar dukshëm, ku vetëm vitin 2024, sipas statistikave të organizatave ndërkombëtare, aeroporti i Prishtinës i ka pasur mbi 4 milionë udhëtarë në mesin e tyre turistë. Duhet theksuar se projekti PPSE ka punuar me shumë përkushtim, po ashtu, edhe në aspektin e rritjes së numrit të produkteve për turizmin malor", përfundoi Krasniqi.

Për 12 vjet, projekti PPSE ka ndikuar ndjeshëm në zhvillimin sistematik të turizmit duke punuar me aktorët lokalë dhe institucionet lokale e qendrore për të zhvilluar një ekosistem funksional turistik.

Gjatë kësaj periudhe turizmi është kthyer në një burim të qëndrueshëm të të ardhurave dhe punësimit, veçanërisht për të rinjtë, gratë dhe komunitetet në zonat rurale. Kjo konferencë është përmbyllur me panelin me temën "Rruga përpara e turizmit të Kosovës".

## KESCO apelon për kursim të energjisë elektrike për shkak të mungesës së prodhimit vendor

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Kompania private KESCO përmes një njoftimi për medie ka bërë me dije se është njoftuar se nga dita e shtunë e në ditët në vazhdim do të ketë mungesë të theksuar të prodhimit vendor të energjisë elektrike, dhe kjo në rastin më ekstrem nënkupton që e gjithë sasia e energjisë elektrike për konsumatorët do të duhet të mbulohet përmes importit. "Pavarësisht sfidave të mëdha logjistike dhe kostos së lartë të energjisë në tregjet

ndërkombëtare, KESCO është duke ndërmarrë të gjitha përpjekjet për të siguruar furnizimin e nevojshëm dhe për të garantuar qëndrueshmëri në sistem", ka njoftuar KESCO.

Më tutje, KESCO ka thënë se importi i një sasive të tillë të energjisë elektrike paraqet vështirësi të mëdha në aspektin teknik dhe financiar dhe ka bërë thirrje për qytetarët që të kursejnë. "Megjithatë, importimi i një sasive kaq të

madhe paraqet vështirësi të konsiderueshme si nga aspekti teknik, ashtu edhe ai financiar. Për të minimizuar ndikimin e kësaj situatë, KESCO u bënë thirrje të gjithë konsumatorëve që të aplikojnë masa të menjëhershme të kursimit të energjisë elektrike. Çdo kilovatorë e kursyer ndihmon në ruajtjen e stabilitetit të furnizimit dhe në zvogëlimin e kostos së përgjithshme, që përndryshe do të rëndonte mbi të gjithë ne", ka njoftuar KESCO.



# SULMI I SHBA NDAJ IRANIT MUND TË JETË MË I MADH NGA SA MENDOHEM: JA DY SKENARËT E MUNDSHËM



A janë SHBA pranë përfshirjes në luftën Izrael-iran në Lindjen e Mesme?

Si do të dukej një sulm nga Trump ndaj mullahëve dhe si do të reagonte regjimi në Teheran?

Sipas mediave amerikane, Presidenti i SHBA, Donald Trump, ka miratuar planet e ushtrisë për një sulm ndaj regjimit të mullahëve në Iran

dhe ushtrisë së tij. Sipas "Wall Street Journal" dhe "New York Times", mungon vetëm urdhri përfundimtar për sulmin.

Pyetja është: Sa shumë do të angazhohen SHBA-të përkrah Izraelit në luftën kundër Iranit? Amos Yadlin, ish-gjeneral i Forcave Ajrore izraelite dhe dikur shef i inteligjencës ushtarake, përmend për BILD dy opsione të mundshme.

## Skenari 1: Trump sulmon në mënyrë të izoluar impiantin bërthamor në Fordo

I pari është një sulm i izoluar dhe i synuar ndaj impiantit bërthamor nëntokësor në Fordo. Ky sulm, sipas Yadlin, do ta kthente shumë prapa programin bërthamor të Iranit dhe do të dërgonte një mesazh të qartë për regjimin në Teheran.

Fjalë për fjalë ai thotë: "Një sulm vetëm ndaj Fordo-s do të ishte një goditje e madhe për programin bërthamor iranian dhe do t'i bënte të qartë regjimit se SHBA do të tërhiqet, nëse Irani nuk reagon ushtarakisht – dhe kështu do të hapej rruga për negociatë".

Për një sulm të tillë, SHBA do të përdorte armë shkatërruese për bunkerë të tipit GBU-57.

Këto mund të depërtojnë deri në 60 metra dhe e betoni, duke shkaktuar dëme të mëdha në thellësi të nëntokës.

Megjithatë, Irani ka gjasa të hakmerret ndaj bazave ushtarake amerikane në Gjirin Persik, prandaj Yadlin e sheh opsionin e dytë si më të mundshëm.

## Skenari 2: Sulm i gjerë ushtarak nga SHBA

Ky opsion i dytë, sipas Yadlin – i cili në vitin 1981 mori pjesë si pilot luftime në sulmin ndaj reaktorit bërthamor irakian në Osirak – do të ishte një goditje ushtarake më e gjerë. Një ndërhyrje e tillë mund të parandalonte paraprakisht një hakmarrje të mundshme iraniane për sulmin ndaj Fordo-s.

Sipas Yadlin, do të duhej të shënjestroheshin edhe

pozicionet raketore iraniane që mund të kërcënojnë objektiva amerikane në Gjirin Persik, si dhe forcat që mund të përgatiten për të bllokuar ngushticën e Hormuzit.

"Një sulm më i gjerë nga SHBA, si një mënyrë për të parandaluar hakmarrjen iraniane, do të përfshinte gjithashtu në shënjestër raketat që kërcënojnë interesat amerikane në Gjirin Persik, si dhe forcat iraniane që mund të tentojnë bllokimin e ngushticës së Hormuzit," shpjegon ai.

Nuk është e qartë nëse Donald Trump do të japë dritën jeshile për operacionin. Arsyeja: ndryshe nga Izraeli, që ndodhet rreth 1000 kilometra larg Iranit, Irani mund të hakmerret rëndë ndaj bazave amerikane në rajon, të cilat ndodhen në disa raste vetëm 100 kilometra larg territorit iranian. (BILD)

## DRONE, HAKERA DHE FURGONË ME EKSPLOZIVË: 'PARANOJA' E REGJIMIT TË TEHERANIT PËR SPIUNËT E MOSSADIT

Nga Guido OLIMPIO,  
*Corriere della Sera*

Mossadi përfshiu gjithashtu agjentë të punësuar në vend. Sulmet e synuara kundër udhëheqësve ushtarakë vazhdojnë, Shin Bet ndalon dy të dyshuar për bashkëpunim me Pasdaran. Është fronti i dytë i luftës, ai brenda dy vendeve. Intensiv, plot kthesa dhe kthesa, por edhe propagandë.

### Sulmet

Shërbimet iraniane të sigurisë kanë ftuar popullsinë të raportojë sjellje të çuditshme, "ata që marrin pako natën", lëvizje të dyshimta të furgonëve. Disa media lokale, të zellshme, kanë shkruar më tej duke përfshirë ata që janë "të maskuar" ose me "vizorë". Është pasqyrimi i asaj që ndodhi në fillim të Operacionit Rising Lion kur bërthamat e Mossadit - ndoshta të përbëra nga elementë vendas dhe disa "të jashtëm" - vepruan "prapa vijave" duke shkatërruar lëshuesit dhe duke vrarë personalitete. Në Teheran ata besojnë se janë ende aktivë, të gatshëm për t'u përgjigjur. Dhe i "shohin" ata kudo.

"Izraelitët" dyshohet se u punësuan për kompani transporti – siç e denoncojnë iranianët – për të udhëtuar pa probleme me automjete të transformuara në platforma për dronë. Dhe kanë dalë foto të kamionçinave, të ngjashme me atë të përdorur për të eliminuar kreun e programit bërthamor

Mohsen Fakrizadeh: në bagazh ai fshehu një mitraloz të "udhëhequr" nga distanca.

Megjithatë, këtë herë ata dyshohet se përdorën raketa antitank Spike 2 me të njëjtin sistem: ja imazhe të tjera të pozicioneve të qitjes me komponentët e braktisur. Një antenë, një trekëmbësh. Është e mundur që ato të kenë qenë instrumenti për të qëlluar shtëpitë e ndonjë shkencëtari. Versioni i burimeve, i rilancuar gjithashtu në mënyrë anonime nga ato izraelite, tregon për një mision që filloi në tetor, me mobilizimin e ekipeve të para për të menaxhuar mbërritjen e materialit: pajisjet shpërthyes, avionët e vegjël, pajisjet e komunikimit. Dhe më vonë për të zgjeruar rrjetin e mbështetjes ndërsa prisnin një urdhër. Bastisje Autoritetet njoftuan varjen e një spiuni të arrestuar në vitin



2023 (ai kishte përdorur një dron), pastaj një seri arrestimesh. Një bastisje në Kurdistan midis bashkëpunëtorëve të dyshuar të Mossadit, arrestimin e individëve të kapur duke fotografuar ndërtesa, ndalimin e njerëzve që përhapnin lajme denigruese ose lajme që ishin të rrezikshme për sigurinë e brendshme. Aktiviteti i dokumentuar me imazhe për të nënvizuar reagimin. Burra të lidhur në tokë. Ndjekja e një kamioni me një ngarkesë "eksplozivësh" nën dysheme (dukeshin si pako droge). Municione, radio me dy drejtime, por edhe disa llastiqe të konfiskuara nga një qeli në veriperëndim. Disa dronë. Një

laborator i vogël.


Gjuetia për 007 është gjithashtu preteksti për të shtypur më tej çdo formë opozite, për t'i mbyllur gojën atyre që nuk janë të lidhur me vijën patriotike të përsëritur nga Khamenei. Një qëndrim i ndarë nga ajo pjesë e kombit që ende beson në regjim, por edhe nga ata që mbrojnë sovranitetin e Republikës. Ndër të tjerë, reperi disident Tommaj Salehi thuhet se ka përfunduar në burg. Alarmet justifikohen nga ajo që po ndodh çdo ditë. Tel Avivi ka pretenduar se ka eliminuar kreun e ri të komandës së emergjencës Ali Shadmani në një vend që ushtria e besonte të ishte sekret dhe i sigurt. Fati i Gjeneralit Sayed Mousavi, shefit

të ri të shtabit, është i pasigurt, gjithashtu një objektivi i mundshëm i një sulmi. Të dy kishin marrë detyrën së fundmi. Ky lajm nxiti "paranojen" dhe është i dobishëm në luftën psikologjike.

Megjithatë, edhe në Izrael nuk e nënvlerësojnë kundërshtarin. Shin Bet ka bllokuar dy qytetarë të dyshuar për bashkëpunim me "rojet", të fundit në një grup ushtarak të rekrutuar në këmbim të parave dhe të gatshëm për të vrarë. Asnjëherë më parë ky kërcënim dikur i paimagjinueshëm nuk është rritur kaq shumë sa në dy vitet e fundit. Censura është shtrënguar për të parandaluar shpërndarjen e klipeve mbi objektivat.

### Hakerët

Beteja është përhapur në botën "dixhitale". Hakerët kanë ndërprerë programet televizive kombëtare. Një grup, Predatory Sparrow, mori përgjegjësinë për një veprim që bllokoi bankomatet dhe më pas hakoi një kasafortë kriptomonedhash të lidhur me Iranin. Iniciativa të ngjashme po përgatiten nga "piratët" simpatizues të Teheranit. Ky është vetëm fillimi.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Kosova mes 10 vendeve më të mira në Botërorin e Xhudos

Me luftërat e kategorisë mbi 78 kilogramë të xhudistëve dhe mbi 100 kilogramë të xhudistëve, kanë përfunduar garat individuale në Kampionatin Botëror të Xhudos në Budapest të Hungarisë. Në

Botëror, garuan 556 xhudistë nga 93 vende të ndryshme, kurse Kosova është përfaqësuar me tre xhudistë, ndërsa ka siguruar dy medalje. Distria Krasniqi fitoi medaljen e argjendtë në

kategorinë deri 52 kilogramë derisa Laura Fazliu mori të bronzën në kategorinë deri 63 kilogramë për ta konfirmuar suksesin e Kosovës në këtë sport. Falë këtyre medaljeve të fituara

nga Krasniqi e Fazliu, Kosova është renditur në top 10 të shteteve më të suksesshme të Botërorit, pra ka përfunduar në pozitën e 10 prej 93 vendeve. Kosova tani numëron dhjetë

medalje nga kampionatet botërore për të rritur. Po ashtu, Kosova i ka edhe pesë medalje olimpike, prej të cilave tri të arta si dhe ka plot 25 medalje nga kampionatet evropiane.

# Mbi një mijë fëmijë vrapuan në Prishtinë për Ditën Olimpikë



**PRISHTINË, 20 QERSHOR** - Mbi një mijë fëmijë të shkollave fillore të Prishtinës kanë realizuar sot vrapimin olimpiq dhe kanë praktikuar disiplina të ndryshme sportive në kuadër të Ditës Olimpikë. Ky aktivitet i organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës në kuadër të Javës Olimpik, vjen në moton "Le të lëvizim" që ka për qëllim ta tregojë rëndësinë e aktivitetit sportiv në shëndetin e fëmijëve. Në hapje të Ditës Olimpikë, presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, theksoi se lëvizja është shumë e rëndësishme për fëmijët pasi i bënë ata më të shëndetshëm. "Është dita kur festojmë sportin, dita kur festojmë shëndetin dhe lumturinë tuaj... Ky vit ka qenë mjaft masiv dhe

kemi pasur përkrahje të jashtëzakonshme nga të gjitha komunat e Kosovës, pra nga 26 komuna... Dita olimpikë dhe motoja e kësaj dite 'Let's move', apo 'Të lëvizim' është shumë e rëndësishme për ju fëmijë të dashur sepse të lëvizim, na bënë të shëndetshëm, të merremi me sport. Besoj se shumica prej jush merreni me sport e disa të tjerë kanë synime që të merren me sport... Komiteti Olimpik do të jetë gjithmonë krahë jush, gjithmonë do ta keni përkrahjen tonë sepse ju jeni e ardhmja e Kosovës", ka thënë Krasniqi. Ndërsa kryetari i Federatës së Atletikës së Kosovës, Halil Sylejmani, deklaroi se përmes këtyre aktiviteteve, Kosova po i

tregon botës që e ka prioritet marrjen me sport. "Faleminderit të gjithë juve që keni ardhur sot bashkërisht që të vrapojmë, të bashkohemi, të tregojmë që jemi të shëndosh, të merremi me sport, e kryesisht me atletikë, sepse atletika është mbretëresha e sporteve... Kemi punuar për një muaj e gjysmë për këtë ditë që ta shënojmë dhe t'i tregojmë Federatës Botërore të Atletikës dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar që ne kemi fëmijë, vajza dhe djem të cilët sot këtë ditë do ta shënojnë në paqe dhe në liri të gjithë së bashku", ka deklaruar Sylejmani. Përveç Prishtinës, aktivitete të ngjashme janë shënuar gjatë kësaj jave edhe në 26 komuna të Kosovës.

### SHKURT

#### Kapiteni Rron Ramadani, besnik i KH Kastrioti

KH Kastrioti ka njoftuar se kapiteni Rron Ramadani nuk do të largohet nga skuadra. Ky klub e ka vlerësuar kapitenin si zemrën e skuadrës, kurse besojnë se për Ramadanin në krye do të vazhdojnë të shkruajnë faqe të reja suksesi. "Tifozë të dashur të KH Kastrioti, me krenari ju njoftojmë se kapiteni ynë, Rron Ramadani, do të vazhdojë të jetë pjesë e klubit tonë edhe në sezonin e ri! Rroni është më shumë se një lojtar – ai është zemra dhe shpirti i luftarak i skuadrës sonë, një udhëheqës i lindur me karakter të fortë dhe përkushtim të pakompromis ndaj fanellës që mban. Me të në krye, jemi të bindur që do të vazhdojmë të shkruajmë faqe të reja suksesi për hendbollin ferizajas. Sezioni i ri, e njëjta pasion – kapiteni ynë në ballë të betejave!", thuhet në njoftimin e Kastriotit.

#### Dinamo City paraqet Berishën

Dinamo e ka paraqitur transferin e ri prag të përvojës evropiane (Ligën e Konferencës). Klubi i Superiores ka zyrtarizuar marrëveshjen me talentin 19-vjeçar, Hekuran Berisha, një qendërsulmues premtues që mbërrin te blutë pas një përvojë të suksesshme në Kosovë në radhët e Dukagjinit. Lojtari, pas hedhjes së firmës në kontratë, është nisur menjëherë drejt Ohrit, për t'u vënë nën urdhrat e Ilir Dajës. "Mirë se vjen Hekuran Berisha! Hekuran Berisha është lojtari më i ri i Dinamo City. Ai është 19 vjeç dhe luan në pozicionin e qendërsulmuesit. Lojtari ka firmosur kontratën me klubin tonë dhe më pas ka udhëtuar drejt Ohrit për t'iu bashkuar menjëherë skuadrës në stërvitje. Berisha vjen pas një sezoni të mirë me Dukagjinin në Kosovë, ku ka shënuar 11 gola. Ai vlerësohet si një element i rëndësishëm për të tashmen dhe të ardhmen e Dinamo City. Suksese Hekuran Berisha me fanellën blu!", thuhet në njoftimin e Dinamo Cityt.

#### Milani në bisedime me Leverkusenin për Xhakën

AC Milan thuhet se ka filluar tashmë bisedimet me Bayer Leverkusenin për transferimin e mesfushorit shqiptar, Granit Xhaka, këtë verë. "Rossonerët" janë të interesuar ta përforcojnë skuadrën e tyre edhe me shumë këtë verë, pasi synojnë t'u kthehen garave evropiane. Një nga emrat më të përfolur për t'u transferuar këtë verë në "San Siro" është shqiptar Granit Xhaka, i cili pëlqehet shumë nga drejtuesit e Milanit. Sipas ekspertit të transferimeve Fabrizioo Romano, Milani bëri kontakt të drejtpërdrejtë të enjten me drejtuesit e Bayer Leverkusenit për Xhakën. Bisedimet klub me klub, sipas Romanos, kanë filluar pasi Xhaka është i hapur për t'iu bashkuar me projektin e Milanit. Transferimi i mesfushorit shqiptar mund t'i kushtojë gjigantit italian rreth 15 milionë euro.

## Nora Gjakova bëhet anëtare e Komisionit të Sportistëve të IJF-së

**PRISHTINË, 20 QERSHOR** - Federata e Xhudos e Kosovës ka njoftuar se kampionia olimpikë Nora Gjakova është zgjedhur zyrtarisht anëtare e Komisionit të Sportistëve të Federatës Ndërkombëtare të Xhudos (IJF), një rol me rëndësi të veçantë për të ardhmen e këtij sporti në nivel

global. "Me krenari të madhe ju njoftojmë se Nora Gjakova është zgjedhur zyrtarisht anëtare e Komisionit të Sportistëve të IJF (Federata Ndërkombëtare e Xhudos)! Pas një karriere të shkëlqyer si Kampionë Olimpikë, medaliste botërore dhe kampione evropiane, Nora tani do të japë

kontributin e saj edhe jashtë tatamit, në një rol vendimtar për të ardhmen e sportit të xhudos. IJF vlerëson lart eksperiencën, perspektivën dhe përkushtimin e saj, cilësi këto që do ta bëjnë Norën një përfaqësuese të jashtëzakonshme për xhudistët kudo në botë. Urime,

Nora! Ti jo vetëm që e ke ngritur flamurin e Kosovës në arenat më të mëdha, por tani po ndihmon edhe në formësimin e të ardhmes së xhudos për brezat që vijnë. Jemi me ty dhe krenarë për ty, sot dhe gjithmonë!", thuhet në njoftimin e Federatës së Xhudos së Kosovës.



## Titulli vendoset në finalen e fundit

INDIANAPOLIS, 20 QERSHOR - Titulli kampion i NBA-s për vitin 2025 do të vendoset në finalen e fundit, në ndeshjen e shtatë. Indiana Pacersi fitoi me rezultat 108-91 ndaj Oklahoma City Thunderit në finalen e gjashtë "play-off",

duke barazuar 3-3 serinë e takimeve mes dy skuadrave. Tashmë gjithçka për sa i përket ekipit kampion do të vendoset në ndeshjen e shtatë dhe të fundit. Dy skuadrat finaliste, që nuk pritshin të arrinin deri këtu në këtë

fillim-sezon, zhvilluan një tjetër ndeshje të bukur. Në shtëpinë e saj, Indiana nuk zhgënjeu dhe arriti të triumfojë me meritë. Gjashtë basketbollistë të Pacersit realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua Toppin me 20. Për

Oklahoman, Alexander Shai realizoi 21 pikë, por që nuk mjaftuan për të fituar. Ndeshja e shtatë do të luhet të hënën në shtëpinë e Oklahomas. Skuadra e Thunderit do të shfrytëzojë në maksimum faktorin fushë për t'u shpallur



kampion për herë të parë në historinë e NBA-s. Të njëjtën gjë kërkon edhe Indiana.

## Verstappeni: Ja tri çastet më të bukura të karrierës time në Formula 1

HASSELT, 20 QERSHOR - Teksa përgatitet për garën e Çmimit të Madh të Austrisë, në shtëpi të Red Bullit, piloti holandez Max Verstappen ka grumbulluar një numër të konsiderueshëm suksesesh që në moshën 27-vjeçare, duke qenë katër herë kampion bote në Formula 1. Dhjetë vjet pas debutimit, Verstappeni foli jo vetëm për historinë e tij në këtë sport, por edhe për t'i përshkruar ato që ai thotë se ishin tre çastet më të mira të karrierës së tij. Duke nisur sigurisht nga: "Barcelona 2016, është fitorja ime e parë". "Fitorja ime e parë në Formula 1 në garën time të parë për Red Bull. Kujtimi im më i mirë i asaj fundjave është momenti në podium, kur poshtë pashë babanë tim dhe e kuptova se ia dolëm mbanë", ka shtuar holandezi. "Natyrisht, kjo ka qenë gjithmonë ëndrra ime. Mbaj mend se nuk kam fjetur shumë natën pas garës. Nuk e prisja as këtë fitore. Sapo kisha ardhur në ekip dhe më parë kishte pasur disa kritika për promovimin tim në Red Bull, sepse njerëzit mendonin se ishte shumë shpejt", ka përfunduar Verstappenin.



Më tej, piloti i Red Bullit shtoi: "Menjëherë pas garës u emocionova shumë. Unë nuk jam një person emocional nga natyra, por ajo që ndjeva pas garës ishte e madhe. Isha gati të qaja". "Momenti i dytë është Abu Dhabi 2021", ka thënë Max, duke iu referuar fitores së titullit të parë botëror. "Nuk kam nevojë ta ripërtetoj atë të diele, sepse atëherë kam frikë nga një sulm në zemër. I gjithë sezoni ishte shumë intensiv, me një epilog në xhiron e fundit të garës së fundit. Ai sezon ishte shumë intensiv, me dy makina që e shtynë veten në një skuadër të mirë për këtë sport në ekstrem. Bëra më pak

gabime për një sezon të tërë. Sigurisht që ishte shumë i bukur dhe i veçantë, veçanërisht nëse e fitoni". Momenti i tretë i karrierës së Verstappenit ishte gara e Brazilit 2024, kur holandezi arriti të fitonte në një rikthim nga vendi i 17-të: "Nuk më pëlqeu gara, sepse tensioni ishte shumë i lartë në kampionat. Nuk mund të përballoja të bëja një hap të gabuar". "Jo gjithmonë i shikoj të gjitha garat plotësisht, por u ula dhe e pashë me kujdes këtë garë më vonë në shtëpi. Edhe sepse gjatë garës si shofer nuk mund të shohësh gjithçka që ndodh rreth teje", ka deklaruar Verstappenin.

## Messi: Gara jonë me Ronaldon ishte në fushë, nuk jemi shokë, e respektojmë njëri-tjetrin

ATLANTA, 20 QERSHOR - Në një deklaratë që po bën bujë në botën e futbollit, Lionel Messi ka folur hapur për marrëdhënien me rivalin e tij të përjetshëm, Cristiano Ronaldo. Legjenda argjentinase ka theksuar respektin që ka për yllin portugez, duke hedhur dritë mbi një rivalitet që për dekada ka dominuar titujt kryesorë të sportit botëror. "Kam respekt dhe e admiroj Cristiano Ronaldon. Për karrierën që ka pasur dhe vazhdon të ketë. Ai ende po luan në nivele të larta", ka thënë Messi. Ai shtoi se rivaliteti mes tyre ishte i natyrshëm dhe profesional: "Gara mes meje dhe atij ishte në



fushë. Të dy kemi dashur gjithmonë të bëjmë më të mirën për skuadrën. Gjithçka qëndron në fushë". Në lidhje me marrëdhënien jashtë fushe, Messi u shpreh: "Jashtë fushës ne jemi dy djem

normalë. Ne nuk jemi shokë sepse nuk shpenzojmë kohë së bashku, por ne gjithmonë e kemi respektuar njëri-tjetrin". Kjo deklaratë konfirmon atë që shumë adhurues të futbollit kanë besuar gjithmonë: se ndonëse ishin rivalë të mëdhenj në fushë, Messi dhe Ronaldo kanë mbajtur një qëndrim të ndërsjellë të bazuar në respekt dhe profesionalizëm. Rivaliteti Messi - Ronaldo ka qenë një nga historitë më të bukura të sportit modern, dhe kjo deklaratë e Messit sjell një perspektivë më të thellë mbi raportin e dy prej lojtarëve më të mëdhenj në histori.

### SHKURT

#### Bledi Shkëmbi emërohet trajner i ri i Struga Trim Lum

Struga Trim Lum ka zyrtarizuar Bledi Shkëmbin trajner të ri, duke pasuar Ilço Gjorgjioskin në pankinën bardhekuq. Shkëmbi, emër i njohur në futbollin shqiptar si lojtar dhe trajner, vjen pas dy periudhave në krye të KF Tiranës. Pas ndarjes me bardheblutë, ai nis një sfidë të re në Strugë me objektiva afatgjatë. Kontrata me trajnerin korçar është dyvjeçare, me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër. Ndhmës i tij do të jetë Sabien Lilaj, ish-mesfushor i Skënderbeut. Pjesa tjetër e stafit teknik mbetet e pandryshuar: Meriton Gega dhe Dejan Leskaroski si ndihmës, Stefan Meçkarovski trajner kondicional, dhe Dardan Miftari trajner i portierëve.

#### Milani heq dorë nga transferimi i Jasharit

Mesfushori i talentuar shqiptar, Ardon Jashari, vazhdon ta tërheqë vëmendjen e klubeve evropiane, por çmimi i lartë i vendosur nga Club Brugge mund ta ndryshojë rrjedhën e merkatos. Mediumi zviceran "Blick Sport" ka konfirmuar raportimet nga mediet belge, duke bërë me dije se klubi belg nuk është i gatshëm të ulet në negociatë për një shumë më të ulët se 40 milionë euro për kartonin e mesfushorit 22-vjeçar. Kjo kërkesë e lartë ka bërë që disa prej pretendentëve për firmën e Jasharit të tërhiqen, mes tyre edhe Milani, që nuk mund të përballojë një investim të tillë në këtë fazë. Sipas të njëjtave burime, nuk përjashtohet mundësia që Jashari të qëndrojë edhe një sezon tjetër te Club Brugge, ku është shndërruar në një nga lojtarët më të rëndësishëm të skuadrës.

#### Enrique: Jemi të frustruar nga ky rezultat

PSG-ja pësoi humbje nga Botafogo (0-1) në ndeshjen e Botërorit të Klubeve. Trajneri Luis Enrique është shprehur i frustruar pas ndeshjes, derisa ka thënë se kundërshtari ishte i motivuar ndaj kampionëve aktualë të Ligës së Kampionëve. "Sigurisht që jemi të frustruar nga ky rezultat. Ishte një ndeshje shumë e ngushtë. Botafogo u mbrojt shumë mirë, si asnjë skuadër tjetër në Ligën 1 dhe Ligën e Kampionëve. Ishte një ndeshje e vështirë nga fillimi deri në fund, por kjo është normale. Të luash kundër nesh është një motivim ekstra për kundërshtarët tanë", u shpreh Enrique.

#### Liverpooli ofron dy futbollistë për Osimhenin

Kamioni i ri i Premierë Ligës, Liverpooli, është gati të futet seriozisht në "ankandin" për transferimin e Victor Osimhenin, raporton "Mediaset". "Reds" po mendon përfshirjen e dy lojtarëve për ta ulur klauzolën e nigerianit. Në tryezë janë kartonët e Darwin Nunez, i lidhur prej javësh me Napolin dhe Federico Chiesa, profil shumë i pëlqyer nga drejtuesit napolitanë. Një ofertë që Napoli po e vlerëson me kujdes. Osimhen ka refuzuar ofertat milionëshe që kanë ardhur nga Arabia Saudite, në veçanti nga Al Hilal i Inzaghit, klub i gatshëm të ofronte 75 milionë eurot e parashikuara nga klauzola e largimit e vendosur nga De Laurentiis.

## Silva: Do të qëndroj edhe një vit te City

"Kam ende një vit në kontratën time, kështu që është e qartë se mund të largohem nga Manchester City vetëm sezonin e ardhshëm. Unë e di se çfarë do të bëj, por nuk

është ende koha për të folur për këtë", u shpreh Bernardo Silva, një nga shtyllat e "citizens". "Jam shumë i fokusuar te sezoni dhe të ndihmoj ekipin tim. Kur të vijë koha, do të

flas për të ardhmen. Sezonin tjetër do të jem te Manchester City. Do të qëndroj këtu", ka shtuar Silva. Deklarata të qarta, të cilat fshijnë çdo dyshim të paktën për sa i përket

sezonit të ardhshëm. Ditët e fundit pati zëra për një largim të mundshëm të tij, të përgënjeshtuar nga vetë Bernardo Silva. Verën e ardhshme ai mund të

largohet nga City me një transferim falas. Silva ende nuk ka mbushur 31 vjeç, ndaj ka mjaft admirues në Evropë por edhe në Arabinë Saudite.



Rr" Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, [www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com),  
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 [info@kolegijbiznesi.com](mailto:info@kolegijbiznesi.com)

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse në studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

#### Studime Bachelor

1. Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
2. Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)
3. Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
4. Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)

#### Studime Master

1. Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2. Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- > Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- > Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- > Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- > Ekstrakti i lindjes;
- > Kopje e letërnjoftimit;
- > 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- > Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- > CV
- > Certifikatën e lindjes
- > Kopjen e letërnjoftimit
- > Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555  
044/ 049/ 048- 500 – 878



Rr" Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, [www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com), [info@kolegijbiznesi.com](mailto:info@kolegijbiznesi.com)  
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë:

### **SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK**

#### I. PROFESORA

1. Dy (2) mësimdhënës në programin – **Ekonomik**,
2. Dy (2) mësimdhënës në programin – **Juridik**,
3. Dy (2) mësimdhënës në programin – **Menaxhimi i Emergjencave**,
4. Një (1) mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga 18.06.2025 deri më 30.06.2025.

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: [info@kolegijbiznesi.com](mailto:info@kolegijbiznesi.com)

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: [www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: [www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com) ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

## THIRRJE PËR APLIKIM

Kompania "Koal Seeds" Sh.p.k. kërkon një ofertues / kontraktor apo kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për furnizim me mekanizim bujqësor si më poshtë:

1. Traktor JD me kabinë, klimë, 4x4, 80 kw.
2. Makinë mbjellëse misri 4 rendësh me vakum MASCHIO GASPARDO me disqe.

Kompanitë e interesuar duhet të kontaktojnë direkt te përfituesi "Koal Seeds" sh.p.k. nëpërmjet e-mailit apo telefonit, për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë.

Ftesat për Kuotim mund të merren më së largu deri me 26 Qershor 2025.

**Përfituesi:** Kompania "Koal Seeds" sh.p.k.

**Adresa:** Rruga "Skenderbeu" Nr.38-Istog

**Telefoni:** +383(44) 174 5607

**E-maili:** [nazmishasanaj@yahoo.com](mailto:nazmishasanaj@yahoo.com)

Ofertat/propozimet duhet të dorëzohen tek adresa e përfituesit më së largu deri me 5 Korrik 2025.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Ariani Home" SH.P.K. me nr. Unik Identifikues: 811926271 Vushtrri, shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330596984.

-Hyrije Fejza B.I. shpall te pavlefshme arkën fiskale me nr. unik: 811281790.

- Shemsie Lahu shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ismail Qemali".

- Jeton Xhafiqi shpall të pavlefshme patentë shoferin (lejen e kerrit) Piranë Prizren.

- Aleksandar Mihajlovic shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 81070307.

- Kujtim Zeneli shpall te pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të gjimnazit "Frang Bardhi".

- Lule Osmani shpall të pavlefshme diplomën e sh,m, të Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

